



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:138103  
Datë: 04.11.2024  
Numri i dokumentit: 06395781

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1249/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ndërmarrja “NewCo Grand Hotel” Sh.P.K., e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale me seli në Prishtinë, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, kundër debitorit “Selmans Network”, Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Jakov Xoxa”, kompleksi Blini, p.n., duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 674/23 të datës 16.05.2024, me datë 01.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e kreditorit Ndërmarrja “NewCo Grand Hotel” Sh.P.K., e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 674/23 të datës 16.05.2024 **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 674/23 të datës 16.05.2024, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Selmans Network”, Sh.P.K., me seli në Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.136/22, të datës 10.06.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Irfan Kërçaku, ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Ndërmarrja “NewCo Grand Hotel” Sh.P.K., e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale me seli në Prishtinë, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 674/23 të datës 16.05.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e lënë në fuqi Urdhrin për Përmbarim P.nr.136/22, të datës 10.06.2022 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr. 674/23 të datës 16.05.2024 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja “NewCo Grand Hotel” Sh.P.K., e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale me seli në Prishtinë, me datën 10.06.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit “Selmans Network”, Sh.P.K., me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 9,693.29 €.

Përmbaruesi Privat Irfan Kërçaku, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.136/22, të datës 10.06.2022, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 19 të datës 07.09.2020; Faturës: Nr. 20 të datës 29.10.2020; Faturës: Nr. 21 të datës 05.11.2020; Faturës: Nr. 22 të datës 04.12.2020; Faturës Nr. 23 të datës 11.01.2021; Faturës Nr. 24 të datës 08.02.2021; Faturës Nr. 25 të datës 17.05.2021; Faturës Nr. 26 të datës 17.05.2021; Faturës Nr. 27 të datës 17.05.2021; Faturës Nr. 28 të datës 24.06.2021; Faturës 29 të datës 02.07.2021; Faturës Nr. 30 të datës 05.08.2021; Faturës Nr. 31 të datës 06.09.2021; Faturës Nr. 32 të datës 06.10.2021; Faturës Nr. 33 të datës 04.11.2021; Faturës Nr. 34 të datës 06.12.2021, Faturës Nr. 35 të datës 07.02.2022, Faturës Nr.36 të datës 07.02.2022, Faturës Nr.40 të datës 07.04.2022 dhe Faturës Nr.41 të datës 04.05.2022, me të cilat i ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 9,693.29 €, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 674/23 të datës 16.05.2024, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Selmans Network”, Sh.P.K., me seli në Prishtinë

dhe e ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.136/22, të datës 10.06.2022, të lejuar nga Përbaruesi Irfan Kërçaku, ashtu që e ka përfunduar në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Faturës Nr. 19 të datës 07.09.2020; Faturës: Nr. 20 të datës 29.10.2020; Faturës: Nr. 21 të datës 05.11.2020; Faturës: Nr. 22 të datës 04.12.2020; Faturës Nr. 23 të datës 11.01.2021; Faturës Nr. 24 të datës 08.02.2021; Faturës Nr. 25 të datës 17.05.2021; Faturës Nr. 26 të datës 17.05.2021; Faturës Nr. 27 të datës 17.05.2021; Faturës Nr. 28 të datës 24.06.2021; Faturës 29 të datës 02.07.2021; Faturës Nr. 30 të datës 05.08.2021; Faturës Nr. 31 të datës 06.09.2021; Faturës Nr. 32 të datës 06.10.2021; Faturës Nr. 33 të datës 04.11.2021; Faturës Nr. 34 të datës 06.12.2021, Faturës Nr. 35 të datës 07.02.2022, Faturës Nr.36 të datës 07.02.2022, Faturës Nr.40 të datës 07.04.2022 dhe Faturës Nr.41 të datës 04.05.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturave, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura nuk përmban as kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përbarueshmërisë. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivi të këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim nga debitori, e as nuk përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Gjithashtu neni 37 i LPP-së përcakton se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm,*

*mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit."*

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Edhe prova tjetër e bashkëngjitur ndërkohë nga kreditori se përfaqësuesi i debitorit ka pranuar shkresën, nuk është valide për pranimin e faturës përderisa ajo nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i debitorit, por eventualisht ka mundur të pranohet vetëm dërgesa postare në të cilën ka mundur të jetë fatura. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të dërgesës postare por assesi të faturës.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, vlerësojnë se janë tërësisht të qëndrueshme pretendimet e kreditorit se kemi të bëjmë me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe se faturat janë të besueshme përmbartimore sipas 29 par.1 të LPP-së dhe si të tilla janë të ekzekutueshme. Dhe gjithashtu kreditori i ka ofruar rregullisht debitori qasjen në Hapësirat Afariste, ku pra janë edhe faturat të dërguara në email si dhe me postë ku nënshkrimi i marrësi dëshmon faturat 2020 dhe 2021, pra debitori ka qenë në dijen për borxhin, mirëpo gjykata i nënshtrohet shqyrtimit juridik-formal të dokumentit përmbartimor apo atij të besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësisimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Fakti se kreditori ka dorëzuar faturat përmes emailit në adresën elektronike të debitorit është evidente, mirëpo mungon konfirmimi të pranimin të emailit me përmbajtjen të faturave si bazë e të cilave është lejuar urdhëri dhe dorëzimi i till në gjykatë nuk mund të konsiderohet i rregullt dhe hyrja në raport juridik me palët debitore dhe iniciimi i procedurës përmbartimore nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 29 par.3 të LPP-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.1249/24 dt.01.11.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**